

## Raporti Mujor Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRë)

### Qershor 2007

- *04 qershor-5 qershor* - Seminar i organizuar nga AUK-u lidhur me "Ristrukturimi i Energjisë Elektrike në SHBA dhe mësimet për Evropën Jug-Lindore";
- *5 qershor dhe 7 qershor 2007* - Takim me përfaqësuesit e KEK-Sha lidhur me faturën e re që do të aplikohet për tarifën e reja me pakicë;
- *11 qershor 2007* - Njoftimi mbi Shqyrtimin e çmimeve të ngrohjeve qendrore;
- *12 qershor 2007* - Takime me Grupin parlamentar të ORA-së, Komisionin Parlamentar për Ekonomi, Industri, Energjetikë dhe miniera, lidhur me:
  1. Shqyrtimin e Tarifave të reja;
  2. Pozita e ZRRE-së dhe roli i saj në sendërtimin e politikave në energjetikë dhe raportet e saj me institucionet tjera;
  3. Çështja e politikave tarifore;
  4. Mundësitë e partive politike që ta mbështesin dhe të kontribuojnë në krijimin e ambientit për punë efektive të ZRRE-së si institucion me rëndësi të madhe shoqërore (Buxheti, raportet me Parlamentin, krijimi i opinionit publik etj);
- *13 qershor 2007* - Nxjerrja e Planit Implementues për shqyrtimin e çmimit të ngrohjes qendrore;
- *19 qershor 2007* - Takime me përfaqësuesit e kompanisë Gjermane "REMA" lidhur me mundësinë e investimeve private në sektorin energjetik;
- *21 qershor 2007* - Përgatitja e udhëzimeve të përkohshëm për raportet financiare dhe rregullative për informim dhe publikim në Web faqen e ZRRë-së si:
  1. Nxjerrja e Udhëzimit I-04-2007 për Raportimin Rregullativ të kompanive ngrohëse për sezonin e ngrohjes 2007/2008 nga Bordi i ZRRë-së
  2. Nxjerrja e Udhëzimit I-05\_2007 për Tarifa për sezonin e ngrohjes 2007/2008, nga Bordi i ZRRë-së
- *22 qershor 2007* - Intervistimi i kandidatëve nga ana e panelit intervistues të ZRRë-së për pozitën "Analist i koston dhe Çmimeve"
- *27 qershor 2007* - Prezantimi Znj. Theranda Beqiri anëtare e bordit në tryezën e punës në Athinë lidhur me "Çështjet e Rregullative, Tarifave dhe shërbimet e kualitetit".
- *20 qershor 2007* – Takim në lokalet e KOSTT-it me përfaqësuesit e KOSTT-it dhe HC.LUMBARDH, lidhur me Detyrimin për Operim të Sistemit për HC "Lumbardhë".